

MANIFESTI PËR TË DREJTAT E KOMUNITETIT LGBT NË SHQIPËRI!

1. PARANDALO DISKRIMINIMIN!

Diskriminimi dhe paragjykimi mbetet një nga problemet kryesore me të cilat përballet komuniteti në familje, shkollë, shoqëri, vendin e punës etj. Për këtë arsye komuniteti rekomandon:

- **Zbatimi i plotë i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;**
- **Respektimi dhe Promovimi i të Drejtave të Komunitetit nëpërmjet:**
 - Caktimit të pikave të kontaktit në Bashki për çështjet LGBT;
 - Realizimit të fushatave lokale ndërgjegjësuese kundër diskriminimit;
 - Miratimi të politikave të brendshme në Bashki për parandalimin dhe eliminimin e diskriminimit;
- **Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta** mes Bashkive dhe komunitetit;

2. SIGURI!

Mungesa e sigurisë dhe pranimit lehtësisht të të qenit homoseksual, lezbike, biseksual dhe transeksual nga shoqëria, bëjnë që komuniteti të ndihet i pambrojtur dhe të privohet nga të drejtat, që si qytetarë të këtij vendi iu takojnë me ligj. Për këtë arsye rekomandohet:

- **Trajnimi i stafeve të Bashkive dhe Komunave** për të njohur të drejtat e komunitetit LGBT;
- **Trainimi i forcave policore në nivel lokal** për t'u aftësuar në respektimin e të drejtave të komunitetit dhe për të garantuar mbrojtjen e tyre.
- **Vendosja e një numri telefoni falas** për çdo rast emergjence;
- **Të rritet siguria** në rrugë dhe mjetet e transportit publik;

3. SHËRBIME SOCIALE DHE PËRKUJDESJE!

Personat LGBT hasin një mungesë të theksuar apo inefiçencë të shërbimeve sociale. Shërbimet sociale për komunitetin ndikojnë në cilësinë e jetës dhe mirëqenies së tyre. Për këtë arsye rekomandohet:

- **Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale** dhe shërbimeve mbështetëse për komunitetin me fokus të veçantë komunitetin transgjinnor;
- **Hapja e Strehëzave** për komunitetin në nevojë, Qendrave të Këshillimit, Klubeve sociale, etj;
- **Buxhetimi me pjesmarrje** dhe në konsultim me komunitetin pranë çdo Bashkie;

4. STREHIM!

Një nga problemet më të mëdha për komunitetin është strehimi, që prek personat që dëbohen nga familja dhe veçanërisht komunitetin transgjinnor. Për këtë komuniteti rekomandon:

- **T'i jepet përparësi politikave të strehimit për komunitetin**, duke promovuar strehimin e sigurtë të personave në situata emergjence, nga skema e strehimit pranë Bashkive;
- **Sigurimi i strehimit të përkohshëm** dhe të përhershëm për komunitetin transgjinnor, sidomos në Tiranë;

5. PUNËSIM!

Një problem esencial që ndikon në garantimin e mirëqenies sociale të komunitetit LGBT është papunësia. Punësimi i komunitetit forcon mirëqenien e tyre dhe të familjeve. Për këtë arsye rekomandohet:

- **Shmangia e diskriminimit në punësim** duke ofruar mundësi të barabarta për komunitetin;
- **Të shikohet me përparësi punësimi** i komunitetit **transgjinnor**;
- **Të nxitet dhe të mbështeten nismat e vetë-punësimit të** komunitetit LGBT.